


P. Pushina


PROKURORIA E PËRGJITHSHME
Nr. 68/14 Prot.
Datë 02.03.2021.
DREJTORIA Kërkuesi



Zij. hokz

3 Mars 2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANE GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË PËRMET

Nr. 345 Prot,E.N

Përmet , më 26.02.2021

Lenda: Dërgohet raporti vjetor për vitin 2020.

Drejtuar : PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

TIRANË

I nderuar Z. Prokuror i Përgjithshëm,
Bashkëlidhur me këtë shkresë, po ju përcjellim raportin vjetor për vitin 2020 të Prokurorisë
Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DREJTUESI PROKURORISË

ASLLAN BARJAMAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
PERMET.

RAPORTI VJETOR

Në Përmet me 25.02.2020

Në përputhje dhe zbatim të Kushtetutës së Shqipërisë, Kodit të Procedurës Penale, ligjin nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” paraqesim raportin vjetor për punën e kryer, arritjet dhe problematikat e hasura nga Prokuroria Prane Gjykeses Shkalles Pare Permet per vitin 2020.

1. Prokuroria pranë Gjykatës Shkallës Parë Përmet, për vitin 2020 ka respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventen Europiane të të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Kodin e Procedurës Penale dhe aktet e tjera ligjore, për gjithë personat e përfshirë në hetime, pavarësisht rolit që kanë pasur të dëmtuar nga vepra penale, të pandehur, interesuar ose dëshmitar.

1.1 Jane regjistruar tre procedime penale me autor të mitur.

1 procedim penal me 5 pandehur të mitur për veprën penale të “Kryerja e mardhenieve seksuale me dhune” parashikuar nga neni 102/2 K.Penal dhe “Ngacmim seksual” parashikuar nga neni 108/a K.Penal, hetohen me masën sigurimit “Detyrim paraqitje në policinë gjyqësore” parashikuar nga neni 234 K.pr.Penale.

1 Procedim penal për veprën penale të “Vjedhjes” parashikuar nga neni 134/2 K.Penal, me dy të pandehur të mitur, janë hetuar dhe gjykuar në gjendje të lire, për njerin prej tyre është aplikuar shmangia nga denimi penal dhe tjetrin pezullim denimit me burg me marrvëshje, dërguar për gjykim brenda afatit tre mujor.

1 Procedim penal për veprën penale “Falsifikim kartmonedhave” parashikuar nga neni 183/2 K.Penal, me një të pandehur të mitur dhe një mbi 18 vjeç, janë hetuar dhe po gjykohen gjendje të lire, cështja dërguar për gjykim brenda afatit 3 mujor.

Për 1 të pandehur të mitur akuzuar për veprën penale “Shkatërrimit të pronës nga pakujdesia” parashikuar nga neni 161 K.Penal, është aplikuar shmangia nga denimi penal sipas ligjit Nr. 37/2017 “Kodi i drejtësisë penale për të mitur” në Prokurori është krijuar një seksion për të miturit, por për shkaqe objektive (mungese burimeve njerzore) nuk është arritur të plotësohet vendi vakant i kordinatorit.

Sa përket procedimeve penale që kanë si viktime të mitur, janë regjistruar dy procedime penale, 1 procedim për veprën penale “Përndjekje” parashikuar nga neni 121a K.Penal, me viktime të mitur dhe ceshtja është hetim dhe 1 procedim penal për veprën penale “shkelje rregullave qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 290/1 K.Penal për të cilin është kërkuar pushimi ceshtjes në gjykatë.

1.2 Bashkëpunimi ndërinstitucional ka qënë përgjithësisht i mirë dhe pa problematika të theksuara. Për vitin 2021 kërkohet dhe do të vihet theksi në një bashkëpunim më të madh dhe efikas me Shërbimet e Policisë së Shtetit si dhe me organet e qeverisjes vendore në luftën kundër krimit të “Kultivimit të bimëve narkotike” parashikuar nga neni 284 K.Penal si dhe veprave penale që kanë për qëllim mbrojtjen e florës dhe faunës, pasi për vitin 2020 referimet për veprat penale kundër mjedisit, flores dhe faunës që janë një pasuri e rrethit Përmet, kanë qënë minimale nga policia e shtetit por dhe organe të tjera që kanë për qëllim mbrojtjen e mjedisit, pyjeve, kullotave dhe burimeve ujore. Vlen për t’u veçuar bashkëpunimi shumë i mirë Drejtorinë Përgjithshme Policisë Shtetit Tiranë në hetimin e një procedimi penal me mbi 30 persona në hetim për vitin 2020. Bashkëpunim efikas ka pasur dhe me Drejtorinë Vendore Policisë dhe Komisaratin e Policisë Përmet dhe shërbimet e policisë sipas seksioneve por dhe me Gjykatën e Shkallës Parë Përmet, Prokurorinë e Apelit, Zyrën e Përmbarimit Gjyqësor Përmet, Shërbimin e Provës Përmet.

1.3 Sa i përket përdorimit të metodave speciale të hetimit dhe hetimeve proaktive, ato janë kryer në 4 raste. Në hetimin e dy procedimeve penale për veprën penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” parashikuar nga neni 284/2 K.Penal dhe për 1 procedim penal për veprën penale “Prodhim dhe shitje narkotikeve” parashikuar nga neni 283/2 K.Penal dhe 1 për veprën penale “Plagosje rënde me dashje” parashikuar nga neni 88 K.Penal

1.4 Për vitin 2020 bazuar në aktet e përcjella nga Prokuroria Përgjithshme është regjistruar një procedim penal që lidhet me procesin e verifikimit të integritetit të personave që ushtrojnë detyra shtetërore ose funksione publike aktualisht ceshtja është në hetim.

2. Për vitin 2020 janë regjistruar në total 207 materiale kallëzuese, nga të cilat 168 janë regjistruar si procedime penale, 107 procedime penale janë mbartuar nga viti 2019.

Në total janë hetuar 275 procedime penale me 144 persona nën hetim ose persona që u është regjistruar emri në regjistrat e veprave penale, nga të cilët 20 janë hetuar me masën sigurimit personal arrest burg-7 arrest shtepi-30 detyrim paraqitje-5 persona me masën sigurimit personal garanci pasurore, 1 me masë sigurimi mjekim detyruar në një spital psikiatrik dhe 81 persona janë hetuar në gjendje të lirë.

- Për 31 procedime penale ka pasur zgjatje të afatit të hetimeve paraprake sipas të dhenave me poshte.

Për 8 procedime penale, ka pasur zgjatje të afatit të hetimeve paraprake nga 9 muaj deri në 1 vit me 60 persona në hetim nga të cilët 9 me masë sigurimi “arrest burg”, 5 me masë sigurimi “detyrim paraqitje në policinë gjyqësore” dhe të tjerët në gjendje të lirë.

Për 13 procedime penale është marrë zgjatje afati deri në 6-9 muaj, me 15 persona ne hetim, hetuar ne gjendje te lire.

Per 3 procedim penale ka zgjatje te hetimit mbi 1 vit me 5 persona ne hetim, nje person ne hetim ne burg dhe personat e tjere hetohen ne gjendje te lire.

Për 7 procedime penale zgjatja ka qënë mbi afatin 3 mujor, me 7 persona hetim hetuar gjendje te lire, nga te cilet nje person ne hetim me masen e siurimit personal arrest burg, ndersa 6 persona ne hetim ne gjendje te lira.

2.1 Çështje të përfunduara.

Janë derguar 52 procedime penale me kërkesë për kalim per ceshtje per gjykim, me 73 te pandehur, nga të cilat janë vendosur si më poshtë.

Për 15 procedime penale, janë ende ne fazën e seancës paraprake.

Për 16 procedime penale është vendosur dergimi ne gjyq themel dhe janë dënuar 17 pandehur nga te cilet 11 me denime alternative, dy me denime me gjobe dhe 4 denuar me burg.

Për 8 procedime penale për të cilat është kërkuar kalimi për gjykim, në seancë paraprake nuk është pranuar kerkesa e prokurorit dhe janë kthyer aktet për plotësim hetimesh. Nga të cilat pasi janë plotësuar hetimet janë dërguar përsëri për kalimin për gjykim 6 procedime penale me 6 pandehur dhe nga këto për 4 procedime penale është pranuar kërkesa për kalim për gjykim. 2 Procedim penal jane duke kryer hetimet sipas urdhërit gjykatës. Për 2 procedime penale pasi janë kryer hetimet sipas urdherit gjykatës, është kërkuar kalimi për gjykim, gjyqtari senaces paraprake ka vendosur pushimin e ceshtjes penale dhe nuk është bërë ankim nga prokurori.

Për 7 procedime penale është arritur marrveshje midis prokurorit dhe pandehurit dhe janë miratuar nga gjykata.

Janë nxjerrë 3 urdhëra penal, nga të cilët 2 janë miratuar dhe një kthyer prokurorit për plotësim hetimesh dhe pasi është plotësuar ceshtja ka kaluar për gjykim normal.

Per 2 ceshtje eshte kerkuar kalimi për gjykim dhe ne séance paraprake gjykata vendosi pushimin e ceshtjes penale dhe nga ana e prokurorit është bërë ankim dhe apeli ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës shkallës parë Përmet.

- Per 12 procedime penale eshte **vendosur pezullimi** procedimit penal.
- Për 34 procedime penale është **kërkuar pushimi ceshtjes ne gjykatë**, gjykata nga këto ka kthyer 4 ceshtje per plotesim hetimesh dhe pasi jane kryer hetimet jane derguar persëri me kërkesë për pushim dhe për tre ceshtje është pranuar kërkesa prokurorit dhe për nje ceshtje vazhdon ende gjykimi kërkesës.
- Per 15 ceshtje është vendosur pushim nga prokurori per kundervajtje penale. Vetem per nje vendim pushimi eshte bere ankim nga pala dhe është lënë në fuqi nga Gjykata vendimi pushimit të procedimit penal.
- Për 72 procedime penale është vendosur bashkimi procedimeve. Nga te cilat per 60 ceshtje jane referuar vecmas nga Drejtoria Pergjithshme Doganave ne vitet 2018,2019 dhe 2020

per veprat penale te “Kontraband me mallra te tjera” parashikuar nga neni 174/1 K.Penal dhe “Falsifikimi dokumentave” parashikuar nga neni 186 K.Penal është vendosur bashkimi në një procedim penal të vetëm për shkak se gjithë veprimet e zhdoganimit ne 60 raste te ndryshme, te automjeteve, janë bërë nga Dogana Tre urat Përmet dhe për pasojë po hetohen ne nje ceshtje te vetme penale.

- Për 3 ceshtje është shpallur moskompetenca.
- Për 35 materiale është vendosur mosfillimi procedimit penal, nuk ka pasur ankim nga palet.
- Për 87 procedime penale, vazhdon hetimi dhe janë mbartur për vitin pas ardhës, me 71 persona ne hetim, nga te cilet 5 arrest burg, 8 me arrest ne burg ne mungese, 3 persona ne hetim me mase sigurimi arrest shtepi, 10 detyrim paraqitje ne policine gjyqesore, 3 me mase sigurimi granaci pasurore dhe 42 persona hetohen ne gjenjide te lire.

2.2 Burimet e njoftimeve te veprave penale janë ato klasiket dhe zakonshmet.

- Shërbimet e policisë pranë Komisarariatit të Policisë Përmet dhe Drejtorise Vendore te Policise Gjirokaster kanë referuar 150 referime.
- Nga nenpunes publik jane referuar 5 kallezime penale ne Prokurori.
- Nga shtetasit jane referuar 45 kallezime penale.
- Nga Drejtoria e Tatimeve jane referuar 2 kallezime penale.
- Nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave jane referuar 4 kallëzime penale.
- Për një procedim penal është filluar kryesisht procedimi penal nga prokurori.

Referuar 3 referime per vepren penale te “Kultivimit te bimeve narkotike” parashikuar nga nenet 284, 22 raste për veprën penale të “Vjedhjes” parashikuar nga neni 134 K.Penal, 7 referime për faktin e “Vetevrasjes” ose ndryshe për nenin 99 K.Penal, 4 herë për veprën penale të “Dhunës në familje” parashikuar nga neni 130a K.Penal.

- Nga sherbimet e policisë pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastrë referimet janë me te shpeshta, janë;6 njoftime per faktin e vepres penale te “Prodhimit dhe shitjes narkotikeve” parashikuar nga neni 283 K.Penale, 18 njoftime për veprat penale te “Shkeljes se rregullave te qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 290 K.Penal dhe “Drejtimit pa dëshmi të automjetit” parashikuar nga neni 291 K.Penal, 5 njoftime për veprën penale të “Pastrimi I produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” parashikuar nga neni 287K.Penal.
- Shtetasit kanë njoftuar për 45 raste, kryesisht për veprat penale të “Falsifikimit të dokumentave” parashikuar nga neni 186 K.Penal, “Shpërdorimi detyrës” parashikuar nga neni 248 K.Penal,“Vjedhjes” parashikuar nga neni 134 K.Penal dhe për kundërvajtje penale që ndiqen me ankim ose me kërkesë të dëmtuarit akuzues.

- Nenpunësit publik dhe organet e tjera kanë referuar 11 raste.

Veprat penale me shume te regjistruar dhe hetuara për vitin 2020 janë;

Neni 291 K.Penal 12 proçedime.

Neni 287 K.Penal 5 proçedime.

Neni 130a K.Penal 5 proçedime.

Neni 134 K.Penal 22 proçedime.

Nenin199 K.Penal 4 proçedime.

Neni 151 K.Penal 6 proçedime.

Neni 186 K.Penal 6 proçedime.

Neni 248 K.Penal 9 proçedime.

Neni 283 K.Penal 6 proçedime.

.....
 2.3 Nga 144 persona në hetim, për vitin 2020, nga të cilët 20 janë hetuar me masësn sigurimit personal arrest burg-7 arrest shtëpi-30 detyrim paraqitje-5 persona me masën sigurimit personal garanci pasurore dhe 82 persona jane hetuar ne gjendje te lire.

- Janë arrestuar në flagrante dhe ndaluar në përputhje me nenet 251,252 dhe 253 K.Pr.Penale me iniciativë të policisë 17 persona.
- Jane nxjerrë nga prokurori në përputhje me nenin 253/1 K.pr.Penale, 35 urdhëra ndalimi nga të cilët janë ekzekutuar 32 dhe të gjithë kanë kaluar testin e ligjshmërisë dhe në gjykatë dhe janë vleftësuar të ligjshëm dhe janë ende pa ekzekutuar 3 për shkak se nuk janë arrestuar të dyshuarit.
- Nga ana e Policisë Shtetit, janë kryer arrestimet dhe ndalimet për sa vijon;

6 të arrestuar për veprën penale të “Drejtimi i automjetit në mënyrë të pa rregullt” parashikuar nga neni 291 I K.Penal.

1 te arrestuar për veprën penale te “Dhunës në familje” parashikuar nga neni 130/a I K.Penal.

1 ndaluar per vepren penale “Tjetersimi mallrave ose sendeve te vjedhura” parashikuar nga neni 287/b K.Penal.

1 person arrestuar për veprën penale “ Prodhim dhe shitje narkotikeve” parashikuar nga neni 283/1 K.Penal.

1 Arrestuar për vepren penale te “Ndihmë për kalim paligjshëm kufirit” parashikuar nga neni 298/3 K.Penal.

6 të arrestuar për veprat penale “ Kryerja e mardhenieve seksuale me dhune me te rritura” parashikuar nga neni 102/2 K.Penal dhe “Ngacmim seksual” parashikuar nga neni 108a/2 K.Penal.

2 ndaluar për vepren penale te “Përndjekjes” parashikuar nga neni 121a/2 K.Penal.

- Për vitin 2020 nga ana e Prokurorisë janë nxjerrë 35 urdhëra ndalimi nga të cilët janë ekzekutuar 32 urdhëra dhe janë vleftësuar të ligjshëm nga gjykata të gjithë të ndaluarit dhe nuk janë ekzekutuar 3 urdhëra.
- Nga ana e Prokurorit, janë nxjerrë 1 urdhër lirimi te menjehershme për 1 të arrestuar për veprën penale “Drejtimi I automjetit në mënyrë të parregullt” parashikuar nga neni 290/1 K.Penal.
- Jemi drejtuar gjykatës me kërkesa për vleftësim të ligjshëm të arrestimit dhe caktim masë sigurimi për 62 persona. Nga të cilët 33 kërkesa prokurorit kanë qënë për masë sigurimi arrest burg, nga të cilat janë pranuar nga gjykata 25 kërkesa duke vendosur nga Gjykata masa sigurimit personal arrest burg dhe për 8 persona të tjerë është vendosur nga gjykata masa e sigurimit personal “Detyrim paraqitje në policinë gjyqesore” parashikuar nga neni 234 K.Pr.Penale.
- Për 5 të arrestuar prokuroria ka kërkuar masën sigurimit personal “Arrest shtëpi” parashikuar nga neni 237 K.pr.Penale, dhe këto kërkesa janë pranuar nga gjykata.
- Për 18 persona është kërkuar gjykatës nga prokurori, caktim masë sigurimit “Detyrim paraqitje në policinë gjyqesore” parashikuar nga neni 234 K.Pr.Penale dhe është pranuar nga gjykata.
- Për 5 persona është kërkuar masa sigurimit personal arrest burg por në seancë, me miratim prokurorit janë vendosur nga gjykata 5 masa sigurimi “garanci pasurore” parashikuar nga neni 236 K.Pr.Penale.
- Për 1 pandehur, është kërkuar vendosja e masës sigurimit “Shtrimi perkoheshëm në një spital psikiatrik” parashikuar nga neni 239 K.Pr.Penale, aktualisht çështja është në gjykim.

2.4 Në zbatim të vendimeve penale të formës së prera është urdhëruar ekzekutimi dënimeve penale për 27 të dënuar. Urdhërat e ekzekutimit, janë nxjerrë në afatet dhe procedurat të përcaktuara nga nenet 463-468 të K.Pr.Penale dhe ligjit nr. 8331 datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

2.5 Sipas strukturës të Kodit Penal konstatohet një shtim i krimeve që parashikojnë dënim në maksimum me burg mbi shtatë vjet. Nuk ka pothuajse asnjë ndryshim të referimit nga Policia Shtetit për figurën e veprave penale të “Kultivimi të bimëve narkotike” parashikuar nga neni 284 K.Penal dhe “Prodhimi dhe shitja narkotikeve” parashikuar nga neni 283 K.Penal nga policia shtetit

per vitin 2020. Ka renie te referimit te veprave penale te “Vjedhjes” parashikuar nga neni 134/1 dhe 2 K.Penal. Ka shtim te thkesuar te referimit te vepres penale te “Drejtimit automejtit ne gjendje te parregullt” parashikuar nga neni 291 K.Penal.

3.Për vitin 2020 janë hetuar 168 procedime penale me 80 persona ne hetim dhe 107 procedime mbartuar nga viti 2019 ne total 275 procedime penale me 144 persona ne hetim. Për 52 procedime penale me 73 të pandehur janë dërguar për gjykim.

3.1 Për vitin 2020 janë dërguar për gjykim 52 procedime penale me 73 te pandehur, nga të cilet 10 me masë sigurimi “Arrest në burg”, 7 arrest në shtëpi dhe 9 detyrim paraqitje ne policine gjyqësore, 2 pandehur me mase sigurimi granaci pasurore ne shumen 1.000.000 leke dhe 45 pandehur kanë qënë në gjendje te lire.

- Kanë përfunduar gjykimin 13 çeshtje me 15 te pandehur.
- Per 4 ceshtje me 5 pandehur kanë marrë pafajësi ne séance paraprake duke u pushuar procedimi penal.
- Për 7 ceshtje është kërkuar në gjykate miratim marrveshjes me 9 pandehur.
- 3 ceshtje jane derguar per miratim urdheri penal me 3 pandehur.
- 25 ceshtje vazhdon ende gjykimi ne themel 8 ceshtje dhe ne séance paraprake mbeten 17 séance parprake.
- 35 ceshtje është bërë kërkesë Gjykatës për pushim.
- 15 çeshtje jane pushuar me vendim te prokurorit.
- 12 ceshtje jane pezulluar.
- 72 ceshtje jane bashkuar.
- 3 ceshtje jane transferuar.

4. Në vitin 2020 janë dërguar 52 procedime penale për gjykim me 73 te pandehur, nga të cilet 10 me masë sigurimi “Arrest në burg”, 7 arrest në shtëpi dhe 9 detyrim paraqitje ne policine gjyqësore, 2 pandehur me mase sigurimi granaci pasurore ne shumen 1.000.000 leke dhe 45 pandehur kanë qënë në gjendje te lire.

- Janë zhvilluar 13 çeshtje me gjykim te shkurtuar, me 15 te pandehur te deklaruar fajtor, nga te cilet 9 jane denuar me denime alternative pezullim denimit me burg dhe tre pandehur jane denuar me burg.
- Me gjykim të zakonshëm jane duke u zhvilluar 8 ceshtje me 9 pandehur me nje person me mase sigurimi arrest burg dhe te pandehurit e tjere ne gjendje te lire.
- Janë duke gjykuar në seancë paraprake 17 çeshtje penale me 38 pandehur nga të cilet 7 arrest burg, 3 arrest shtepi, 2 pandehur detyrim paraqitje ne policine gjyqësore, 2 pandehur me masen granci pasurore dhe te tjeret ne gjendje te lire.

- Për 7 procedime penale është aplikuar marrveshja, me 9 pandehur dhe janë pranuar të 7 marrveshjet.
- Janë nxjerrë 3 urdhëra penal, dy te miratuar nga gjykata dhe nje nuk është pranuar.
- Për 2 ceshtje është kërkuar kalimi për gjykim, me 2 pandehur, hetuar ne gjendje te lire njeri dhe tjetri me deyrtrim paraqitje, nga ana Gjyqtarit seancës paraprake janë kthyer ceshtjet për hetime dhe pasi janë plotësuar hetimet dhe është kërkuar ridërgim për gjykim. Nga ana e Gjyqtarit seancës paraprake është vendosur pushimi cështjes dhe nuk është bërë ankim nga Prokurori dhe kanë marrë formë të prere.
- Për 2 procedime penale, me tre pandehur ne gjendje te lire, pasi përfundimit te hetimeve është kërkuar kalimi për gjykim, nga ana e gjyqtarit seancës paraprake është pushuar cështja. Është ushtruar ankim dhe Apeli ka lënë në fuqi vendimin Gjykatës Shkallës Parë Përmet.

-Me gjykim te drejtpërdrejt është bërë 1 kërkesë nga prokurori, per 1 ceshtje me 1 pandehur me masë sigurimi detyrim paraqitje policine gjyqësore. Kërkesa nuk është pranuar nga gjykata duke kthyer aktet dhe pas kryerjes se hetimeve ceshtja eshte derguar per gjykim, është zhvilluar gjykim shkurtuar dhe pandehuri eshte denuar me denim alternative.

4.1 Në përgjithesi kerkesat për masat dhe llojet e dënimeve të kërkuara nga Prokurori cështjes janë mbeshtetur dhe pranuar nga gjykata.Me perjashtim te dy rasteve kur kërkimet e prokurorit nuk janë mbeshtetur nga Gjykata e Shkallës Parë Përmet, por pas ankimit te Prokurorit dhe pandehurit, Gjykata e Apelit ka vendosur sipas llojit të dënimit që ka kërkuar prokurori ne seancë.

Konkretisht ne një rast për një pandehur akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 88 K.Penal. Prokurori kërkoj në përfundim aplikimin e dënimit alternative, gjykata e denoi me 2 vjet burg pas ankimit të pandehurit Gjykata Apelit, vendosi aplikimin e denimit alternative, pezullim denimit me burg dhe venie ne provë.

Një rast tjetër për 1 pandehur me akuzën e kryerjes vepres penale parashikuar nga neni 278/2 dhe 3 K.Penal, prokurori ne përfundim kërkoj dënimin me 3 vjet burg. Gjykata Shkallës Parë vendosi aplikimin e dënimit altrenativ. Pas ankimit të prokurorit, Gjykata Apelit, pranoj kërkesën e Prokurorit dhe vendosi mos aplikim te pezullimit te denimit.

4.2 Të pandehurit e derguar për gjyq,73 pandehur, rezulton se pjesa me e madhe e tyre janë të padënuar me parë, banor në zonat rurale dhe të papune ose te vete punësuar, me arsim teteklase ose mesem ne pergjithesi.Në lidhje me arsimimin rezulton se 5 pandehur jane me arsim te larte, 30 arsim mesem, 38 janë me arsim teteklase, 2 pandehur e gjinisë femerore, 3 pandehur të mitur.

4.3. Në fushën e mardhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja, vlen për tu thkesuar së në ndryshim nga vitet paraardhese është kërkuar dhe urdhëruar shpallja për kërkim ndërkombëtar për nje te denuar për tu ekstraduar nga autoritetet e drejtësisë Spanjë,denuar me 5 vjet burg për veprën

penale “Ndhimë për kalim paligjshëm kufirit” parashikuar nga neni 298/3 K.Penal. Është kërkuar ndihmë në katër raste autoriteteve të drejtësisë Greke, Kamerun dhe Kosovë, për 4 çështje që janë në hetim. Na është kërkuar 2 herë ndihmë nga autoritetet e drejtësisë të huaja, për të kryer njoftime aktesh të pandehuri dhe njoftim për zhvillim séance, të dyja kërkesat, janë ekzekutuar. Është nxjerre një urdher për kërkimi ndërkombëtar për një pandehur, i akuzuar për veprën penale “Vrasje nga pakujdesia” parashikuar nga neni 85 K.penal, hetuar me masë sigurimi “arrest burg” në mungesë.

5. Ngarkesa Sipas Prokuroreve.

5.1 Prokurore Silvana Pani gjatë vitit 2020 ka hetuar 45 procedime penale nga të cilat 34 regjistruar rishtazi në vitin 2020 dhe 12 të mbartuar nga viti 2019 duke vendosur këtë zgjidhje për këto procedime penale.

11 çështje është kërkuar kalim për gjykim në gjykatë. Për 2 çështje është vendosur pezullimi procedimit penal, për 3 çështje është vendosur pushimi procedimit penal (Kundërvajtje penale) dhe për 2 çështje është kërkuar pushimi çështjes në gjykatë.

Thkesojme se për shkak të arsye objektive nga data 27.02.2020-18.06.2020 Prokuroria Silvana Pani nuk ka ushtruar detyrën, për shkak lejes vjetore dhe udhëtimit drejt Sh.B.A-së.

Nga data 05.10.2020 e aktualisht është e pezulluar me vendim të K.P.K-së.

Janë mbartuar dhe kanë kaluar tek prokurori tjetër 27 procedime penale, për shkak të pezullimit me vendim të K.P.K-së të prokurorit të çështjes.

5.2 Prokurori Asllan Barjamaj.

Ka hetuar 134 çështje penale për vitin 2020, dhe mbartuar 95 procedime penale nga viti 2019 dhe ka marrë dhe 27 procedime penale nga prokuroria Silvana Pani dhe në total ka hetuar 256 procedime dhe për të cilat është vendosur si më poshtë.

- Gjyq janë dërguar 41 çështje penale.
- 32 kërkesa për pushim procedimi penal.
- 10 procedime është vendosur pezullimi.
- 12 procedime është vendosur pushimi procedimit penal.
- 72 procedime penale janë bashkuar
- 3 procedime është shpallur moskompetenca.
- Janë mbartuar 87 procedime penale për vitin 2021.

Nga Prokurori Asllan Barjamaj është urdhëruar për 35 persona ndalimi me urdhër ndalimi nga të cilat janë ekzekutuar dhe quajtur të ligjshëm 32 urdhëra ndalimi nga gjykata. Për 3 të dyshuar për të cilët është nxjerrë urdhër ndalimi ende nuk janë ekzekutuar pasi janë në fazë kërkimesh të personave që nuk gjenden.

- Përgjithesisht kërkimet e prokurorit, për kalimin e çështjeve për gjykim janë mbështetur nga Gjykata dhe gjyqtari séances paraprake me përjashtim te rasteve te meposhtme.

Për 1 ceshtje me një pandehur akuzuar për vepren penale “ Prodhim dhe shitje narkotikeve” parashikuar nga neni 283/1 dhe “Kultivim bimeve narkotike” parashikuar nga neni 284/1 K.Penal. Për herë parë nuk është pranuar kërkesa për kalim gjykim dhe ka vendosur plotësim hetimesh, kryerje akti ekspertimi topografik. Pasi janë kryer hetimet është riderguar për gjykim çështja penale dhe ka kaluar në gjykim themeli dhe aktulisht pandehuri është dënuar.

1 ceshtje me 1 pandehur, është rikthyer çështja, per plotësim hetimesh për kryerje akti eksperti vleresues me akuzat e “Shkatërrim prone” dhe “Dhunim objekteve te kultit” parashikuar nga nenet 150 dhe 132 K.Penal dhe pasi është bërë akti ekspertimit është kërkuar kalimi për gjykim, gjykata ka vendosur pushimin e akuzave.

1 Çështje me dy pandehur, ne gjendje te lire, me akuzën “ Kundërshtim punonjesve rendit publik” parashikuar nga neni 242 K.Penal me dy të pandehur është kërkuar kalimi për gjykim. Gjyqtari seancës paraprake ka vendosur pushimin e çështjes është ushtruar ankim dhe Apeli ka lënë fuqi vendimin e gjykatës.

1 procedim penal me një të pandehur hetuar gjendje te lire, akuzuar për vepren penale te “Vjedhje” parashikuar nga neni 134/1 K.Penal është kërkuar kalimi për gjykim, gjyqtari seancës paraprake ka vendosur pushim ceshtjes. Prokurori ka bërë ankim, Apeli ka lënë në fuqi vendimin gjykatës.

1 ceshtje me nje te pandehur, ne gjendje te lire, akuzuar per vepren penale “ Shkelje rregullave qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 290/2 K.Penal nuk është pranuar kërkesa për kalim për gjykim, pasi gjykata ka shpallur pavlefshem aktin eskpertimit autoteknik, pasi është rikryer akti është dërguar për kalim për gjykim është ne fazë gjykimi.

1 çështje me 1 pandehur, hetuar gjendje te lire, akuzuar për veprën penale të “ Shkatërrimit të pronës” parashikuar nga neni 150 K.Penal, është rikthyer dosja plotesim hetimesh (rikryerje akti ekspertimi vleresues). Pasi është kryer akti është pranuar kalimi për gjykim dhe aktualisht çështja është gjykim themeli.

1 ceshtje me nje te pandehur, me urdhër penal, akuzuar për vepren penale “ Kundërshtim punonjesve rendit publik” parashikuar nga neni 242 K.Penal nuk është pranuar urdheri dhe pas kthimit te akteve është marrë pandehur dhe aktualisht është në gjykim themeli ceshtja.

- Në lidhje me respektimin e afateve te hetimit ka pasur zgjatje te hetimeve paraprake ne 22 procedime penale si me poshte.

Për 6 procedime penale është bërë zgjatje deri ne 3 muaj.

Për 10 procedime penale ka bërë zgjatje deri në 9 muaj.

Për 5 procedime penale ka bërë zgjatje deri në 1 vit.

Për 1 procedim penale për vepren penale “Prodhim dhe shitje narkotikeve” parashikuar nga neni 283/2 K.Penal, me nje person hetim, zgjatje mbi 1 vit.

Nuk ka asnjë pafajësi të marrë në gjykimet e ceshtjeve ne themel, pervec katër pushimi akuzave të dhëna nga gjyqtaret e seancës paraprake te cituara më sipër.

6.Seksionet e Policise Gjyqësore.

Sa i perket policise gjyqesore te seksionit pranë Prokurorisë Shkallës Parë Përmet, rezulton se është kryer një punë e konsiderueshme për vitin 2020, nga oficeri prane Prokurorisë, Agron Nakollari. Ka pasur ne hetim 72 procedime penale të deleguara nga prokurorët.

Për 23 procedime ka referuar dërgimin për gjykim.

31 procedime ka relatuar per pushim ceshtje.

4 per pezullim te procedimit penal.

Ka ne hetim 14 procedime penale.

Kryen detyrat e deleguara dhe urdheruara nga prokurori, por gjithsesi konstatohet vonesë në kryerjen e veprimeve të deleguara, duke mos i kryer në afatin e përcaktuar në urdhër dhe në një kohë të shpejte.

Shërbimet e policisë gjyqësore në Komisarlatin Përmet dhe Drejtorinë Vendore të Policisë, kanë kryer 150 referime për vitin 2020 dhe kanë hetuar 93 procedime penale bazuar mbi urdherat e delegimit te prokurorit . Bazuar në urdherat me shkrim te delegimit te kryera nga prokurori, kanë përfunduar dhe kryer veprimet e deleguara në afatin e përcaktuar përgjithësisht. Shqetësim mbetet mënyra e hetimit të veprave penale të “Kultivimit të bimeve narkotike” parashikuar nga neni 284 K.Penal, “Prodhim dhe shitja e narkotikeve” parashikuar nga neni 283 K.Penal, “Ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit” parashikuar nga neni 298 K.Penal, “Pastrimit te produketeve te vepres penale ose veprimtarisë kriminale” parashikuar nga neni 287 K.Penal, “Kontrabande me mallra te tjera” parashikuar nga neni 174 K.Penal dhe “Kontrabanda nga punonjesit qe lidhen me veprimtarine doganore” parashikuar nga neni 175 K.Penal dhe vepra penale te tjera qe kryhen ne fushen e doganave pasi rrethi Përmet ka pikë doganore dhe kufitare por referimi per veprat penale ne fushen e doganave pothuajse mungojnë nga shërbimet e policisë gjyqësore

7. Buxheti

Për vitin 2020 është zbatuar në mënyrë korrekte dhe pas një auditimi të kryer në vitin 2019, janë marrë masat për të rregulluar problematikat në dokumentacion që janë vrejtur nga auditimi. Konstatohet një buxhet mjaft i kufizuar dhe jo i mjaftueshem për të kryer investimet në mbajtjen e paisjeve te punes, bazës materiale dhe për vitin 2020 kjo problematik ekziston.

Mardheniet me publikun kanë qënë jo problematike dhe brenda kornizave që përcakton ligji, por aktualisht për shkak te nje prokurori në organike është veshtiresuar disa kthim përgjigje ne kohen që përcakton procedura dhe legjislacion dhe për këtë shkak është vendosur një orar dhe datë e

caktuar për ta takuar shtetasit që kanë pretendime ose ankesa te ndryshme nga drejtuesi prokurorisë.

Godina e ish hetusise në inventar të Prokurorisë është jashtë funksionit dhe kërkojmë të merren masa për kalimin e saj në pronësi të organeve te tjera shtetore ose investimit dhe kthimin në gjendje optimale dhe funksionale, pasi dhe ambjentet ne te cilat ushtrojme funksionin aktualisht janë mjaft te kufizuara dhe nuk lejojnë kryerjen e punës në kushte optimale.

Ka shqetësim sa i përket bazës materiale dhe konkretisht mungon një automjet qe te funksionje ne menyre efikase për të kryer levizjen e punonjeseve për arsye pune është kërkuar nje automjet ne gjendje tenkrike optimale, pasi ekzistuesi eshte prodhim i vitit 2004. Kjo ka sjelle që në dy raste te furnizohen me karburant automjetet e punonjeseve te Prokurorisë, cka ka sjelle nje shqetesim dhe terheqje vemendje nga ana e Sekretarit te Përgjithshem dhe për pasojë nga ana jonë janë marrë masa që mos përsëritet më në të ardhmen.

Respektimi disiplinës në punë dhe etika ka qënë korrekt nga punonjësit.

8.Disa të dhëna krahasimore.

Konstatohet nje renie me afro 5% e materialeve referuese dhe kallëzuese me vitin 2019.

Një renie me 10% e të urdhërave te ekzekutimit te nxjerr për këtë vit me vitin 2019.

Ka renie me 45% te numerit te ceshtjeve te referuara nga Policia Shtetit për vepren penale te “Prodhim dhe shitje narkotikeve” krahasuar me vitin 2019.

Ka një renie me afro 30% te numerit te referimeve per vepren penale te “Vjedhjes” parashikuar nga neni 134 K.Penal.

Nga krahasim me vitin paraardhes, rezulton se është rritur me 5% numeri procedimeve penale te regjistruar.

Ka një rritje me 40% të numërit të personave që janë marrë të pandehur me vitin parardhës.

Rritje me 46% të numërit të personave ne hetim nga viti 2019.

Rritje me 30% te numërit të çështjeve te dërguar për gjykim.

Rritje me 45% të numerit te çështjeve penale që kanë pasur zgjatje te afatit te hetimeve paraprake me vitin 2019.

Dyfishuar referimet dhe regjistrimet per vepren penale te “Pastrimit te produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale” parashikuar nga neni 287 K.Penal ne krahasim me vitin para ardhës.

Te dhenat kryesore krahasimore midis viti 2019 dhe 2020, po paraqiten dhe në këtë tabelë.

	Viti 2019	Viti 2020	Ne perqindje
Referime	220	207	
Numer procedimeve	160	168	+5
Urdhera ekzekutimi	30	27	-10

Numeri personave hetim	100	144	+40
Numeri te pandehureve	50	73	+46
Ceshtje Gjyqi	40	52	+30
Kerkese pushim	30	35	+15
Pushuara	7	15	+55
Pezulluara	22	12	-50
Mosfilluara	60	35	-40
Mbartuara	107	87	-20
Mase sigurimi burg	12	20	+60
Te mitur ceshtje	4	7	+75
Pandehur person hetim te mitur	1	8	
Viktima te mitur	3	2	-33
Marrveshje	3	7	+60
Urdher penal	5	3	-40
Bashkuara		72	
Moskompetence	9	3	-70
Seksioni V.P te renda	2	1	-50
Krime kundër familjes	5	3	-40
Kundër pasurise	31	22	-30
Falsifikime	56	10	-80
Mjedisi	5	3	-40
Neni 283	11	8	-40
Neni 284	3	3	0
Neni 278	3	4	+25

Neni 287	2	4	+100
----------	---	---	------

9. Problematika.

9.1 Nga data 05.10.2020 e aktualisht ne organiken e Prokurorisë Pranë Gjykatës Shkallës Parë Përmet është vetëm një Prokuror dhe nje Oficeri Policisë Gjyqësore dhe kjo ka sjellë vështirësi në mirëfunksionimin e punës hetimore.Si dhe është një shqetësim evident, pasi dhe prokurori vetëm që ushtron funksionin ka mbi 10 vjet në këtë qytet dhe për pasojë, ne një rast të mundshëm përjashtim prokurori ose papajtueshmërie, nuk ka mundësi objektive zvendesimi.

9.2 Rezulton se ka një shtim te veprave penale kundër krimit të organizuar dhe pastrimit të parave që kërkojnë një hetim specilizuar dhe në këtë pikë stafi Prokurorisë dhe policisë gjyqësore ne Drejtorine Vendore, ka mangësi te theksuar në hetimin e ketyre verpave penale dhe nuk ka aktualisht asnjë procedim penal të dërguar për gjykim për veprën penale “Pastrimi produketeve te vepres penale ose veprimtarise kriminale” parashikuar nga neni 287 K.Penal ose marrjen e masave kunder pasurise te dyshuar me prejardhje kriminale si dhe veprave penale ne fushen e tatimeve dhe evazionit tatimor.

9.3 Kemi konstatuar se nuk ka pasur nje goditje efikase, kundër veprave penale të “Kultivimit të bimeve narkotike” parashikuar nga neni 284 K.Penal, megjithese eshte kerkuar dhe bashkepunim Drejtorise Pergjithshme Policise Shtetit Tirane per te mbikqyrur me dron disa zona te specifikuara nga ana jonë, nje veprim tille nuk eshte bere e mundur te kryhet dhe vihet ne dispozicion. Ka renie te materialeve referuese nga policia shtetit, per vepren penale te “Prodhim dhe shitja e narkotikeve” parashikuar nga neni 283 K.Penal, “Ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit” parashikuar nga neni 298 K.Penal dhe per veprat penale kunder mjedisit.

9.4 Mungesa e kordinatorit prane Prokurorisë që do të asistonte te demtuarit nga veprat penale, viktimat, te miturit. Problem është dhe mungesa ne strukturat e Komisariatit te Policisë Përmet, e nje oficere policisë gjyqësore (femer), e cila duhet te asistojte ne cdo rast ne marrjen ne pyetje te viktimave që janë objekt i veprave penale të dhunës seksuale.

9.5 Kemi hasur pengesa ne bashkepunim me Institutin e Policisë Shkencore Tiranë, për sa përket kryerjes se akteve te ekspertimit kirbentik te aparateve celular te demtuareve ose dyshuareve. Nuk kryhen aktet e ekspertimit për shkak se pretendohet një ngarkese e madhe dhe procedimet për të cilat kërkohet nga ana jonë kryerja e akteve ekspertimit konsiderohen jo te rendesishëm nga ana e I.P.Sh-së Tiranë. Si pasojë janë krijuar probleme serioze ne hetimin e të paktën tre procedimeve penale, 1 procedim penal me 5 te dyshuar persona te mitur dyshuar per veprat penale “ ngacmim seksual” parashikuar nga neni 108/a K.Penal dhe “ Mardhënie seksuale me dhunë me te rritura” parashikuar nga neni 102/2 K.Penal. Për një procedim penal me viktimë të mitur, nga vepra penale “Përndjekje” parashikuar nga neni 121a K.Penal dhe për një procedim penal me mbi 50 persona ne hetim te dyshuar për veprat penale “ Prodhim shitje narkotikeve” parashikuar nga neni 283/2 K.penal dhe për vepra tjetra penale te parashikuara nga nenet 143, 197, 180, 186, 278, 287 K.Penal.

Mos administrimi akteve te ekspertimit, kthim mbrapsht i vendimeve, me pretendimin se ka ngarkese dhe nuk mund te kryejne akte ose mos kryreja ne kohe, ka sjelle nje zvarritje te hetimeve per te paktën per këto procedime penale mbi 9 muaj.

Për vitin 2021 përparësi kryesore do te jetë pikërisht zgjidhja e gjithë problemeve te listura me lartë.

DREJTUESI PROKURORISË
Asllan BARJAMAJ.